

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 788/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Vedat Poterqoi Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, "Erpower" sh.p.k. & "Voltechz" sh.p.k me seli Viti, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos", me nr.të prokurimit: 651-22-12818-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal -Gjilan, më datën 06.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar, ankesa e operatorit ekonomik, "Erpower" sh.p.k. & "Voltechz" sh.p.k me seli Viti, parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 20.12.2022 (me numër protokollit 788/2022, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos", me nr.të prokurimit: 651-22-12818-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal –Gjilan.
- 2. Mbetet në fuqi**, njoftimit Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos", me nr.të prokurimit: 651-22-12818-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal –Gjilan.
3. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues, "Erpower" sh.p.k. & "Voltechz" sh.p.k me seli Viti, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datë 08.12.2022, OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 12.12.2022 AK- Komuna e Gjilanit , refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “Erpower” sh.p.k. & “Voltechz” sh.p.k me seli Viti, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos”, me nr.të prokurimit: 651-22-12818-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal-Gjilan.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 20.12.2022, ka pranuar ankesë nga “Erpower” sh.p.k. & “Voltechz” sh.p.k me seli Viti, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos”, me nr.të prokurimit: 651-22-12818-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal-Gjilan, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 788/2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur - punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës “Çmimi më i ulët” i tenderit të përgjegjshëm, vlera e parashikuar e kontratës: 35,706.98 euro.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 30.12.2022 ekspertja shqyrtuese ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Erpower” sh.p.k& “Voltechz” shpk- Viti të refuzohet si e pa bazuar,
- ti lejohet AK-së që të procedoj tutje me këtë procedurë të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) të ankesës së “Erpower” sh.p.k. & “Voltechz” sh.p.k. me seli në Viti

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër arsyetimit të eliminimit dhe kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku AK-Komuna Gjilan, përmes letrës standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 06.12.2022, ka potencuar:Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Komisioni profesional për ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se ne Dosjen e Tenderit si dhe në Njoftimin për kontratë më saktësisht tek Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit , Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

4. Listës se pajisjeve, ti bashkëngjiten edhe këto dëshmi Deklarata unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet qe

regjistrohen . Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzim , OE duhet te dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për shfrytëzim.

“Mirëpo në ofertën tuaj tek Aneksi nr.7 Pika 5 Ngarkues nuk figuron kjo Paisje ashtu siç është kërkuar nga AK-në dosjen e tenderit si dhe Njoftimin për kontratë. “

Rrjedhimisht, Komisioni Profesional për Ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se oferta juaj është e Papërgjegjshme.

Kundër këtij arsyetimi të eliminimit, parashtruesi i ankesës në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek Autoriteti kontraktues me pretendimet e njëjta ankimore si në ankesën e parashtruar në OSHP, ndërsa AK- Komuna Gjilan përmes vendimit të datës 12.12.2022, refuzon kërkesën për ri shqyrtim si të pa bazuar me arsyetimin e njëjtë si në letër standarde.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Erpower” sh.p.k. & “Voltechz” sh.p.k. - Viti, me tej si parashtruesi i ankesës, ku potencon se në vendimin e datës 12.12.2022, AK e pranon se e kemi pajisjen të cilën e ka kundërshtuar në vendimin e parë. Më tej, OE ankues pretendon se AK nuk ka pasur mundësi të gjejë ndonjë gabim në dokumentacionin tonë dhe është thirrur në sekret afarist të ofertës së dytë për të cilën nuk kemi pasur mundësi të kemi qasje në këto dokumente dhe me këtë AK ka bërë shkelje të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese lidhur me këtë pretendim të OE ankues sqaron se AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 06.12.2022, ka cekur se OE ankues “Erpower” sh.p.k. & “Voltechz” sh.p.k. eliminohet për shkak se tek Aneksi 7, pika 5 Ngarkues nuk figuron kjo pajisje ashtu siç është kërkuar nga AK në dosjen e tenderit, si dhe në njoftimin për kontratë. Gjithashtu, ekspertja shqyrtuese sqaron se edhe në vendimin e AK-së të datës 12.12.2022 kundër kërkesës për ri shqyrtim ceket e njëjta arsye e eliminimit se OE ankues nuk posedon Ngarkuesin sipas pikës 5 të Aneksit 7 të dosjes së tenderit. Andaj, ekspertja shqyrtuese vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues i cili pretendon se në vendimin e datës 12.12.2022 AK e pranon se e kemi pajisjen të cilën e ka kundërshtuar në vendimin e parë sepse në të dy vendimet është e njëjta arsye e eliminimit.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se pasi që AK pretendon se neve nuk na figuron në aneksin 7 Pajisjet dhe Mekanizmi Obligueshme për këtë Projekt në pikën 5 (ngarkues). Në aneksin Nr. 7 Pika 5. Kemi vërtetuar se i përmbushim të gjitha kriteret në DT. Në dokumentet e ngarkuara në sistemin elektronik E- prokurimi, saktësisht File me emrin Lista e Makinerisë Erpower ne faqen 8, e kemi të ngarkuar dokumentin që ju pretendoni se mungon.

Ekspertja shqyrtuese për këtë pretendim të OE ankues sqaron se AK në aneksin 7 të dosjes së tenderit ka kërkuar:

Aneksi 7. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe të bashkëngjiten e kërkuara në FTD)

PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHEM PER PROJEKTIN ME TITULL:			
Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi
1	<u>Kamion vetëshkarkues me kran</u>	1	
2	<u>Kamion transportues me peshë bartëse mbi 10 m3</u>	1	
3	<u>Automjete me shportë speciale për punë në rrjetin elektrik</u>	1	
4	<u>Eskavator</u>	1	
5	<u>Ngarkues</u>	1	

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Sipas Aneksit 7 të dosjes së tenderit, në numrin rendor 5, AK ka kërkuar “Ngarkues”. Kurse OE ankues në dokumentin me titull “Lista e makinerisë Erpower”, fq. 8 të këtij dokumenti ka këto pajisje:

2 Ekspozituesi FLORIM RAMADANI ALTDORF /CH		3042 DHEU BARDHE-TERMINAL Referenca dogjimore	
3 Vendi i origjinit 1 1		4 FR 10673 10/12/2020	
5 Postimi 1		6 Nr. pakete 1	
7 Numri referenc 2020 6886		8 Numri referenc 2020 6657	
9 Marrësi / Importuesi Nr 810889777 N.T.P. " V3 - ING " Llapllasellë Magj, Prishtine Foriza] Graçanicë		9 Paracel pajtojës financiar Nr 810889777 N.T.P. " V3 - ING " Llapllasellë Magj, Prishtine Foriza] Graçanicë	
10 Vendi 10 Vendi I 11 Vendi I 12 Detyjë e vlerës 13 P.P.D		14 Deklarimet ID 810877287 N.T.P. " Jona" Pozhetan Viti	
15 Vendi dërguesi eksportues ZVICERRA		16 Vendi origjinit ITALIA	
17 Vendi i destinacionit KOSOVA		18 Kushtet e dërgesës EXW Alldorf	
19 Identifikimi dhe nacionaliteti i rajtimit transportues në dalje të ri BU024KU AA735BU XS		20 Kushtet e dërgesës EXW Alldorf	
21 Identifikimi dhe nacionaliteti i rajtimit aktiv transportues që ka bën kodin BU024KU AA735BU XS		22 Vlerë e dërgesës dhe e përgjithshme EUR 11,000.00	
23 Kufiri i kërkimit 1,0000000		24 Lloji i transportit 1 1 transp.	
25 Lloji i transportit 30 1 1 kusht		26 Lloji i transportit 30 1 1 transport	
27 Vendi ngarkimit / shkarkimit 30 Lehtësi i mallrave		28 Vendi dërguesi eksportues 3041 PRK DHEU I BARDHE	
29 Zyra dërguese kryesore / dalje 30 Lehtësi i mallrave		31 Artikulli 1	
32 Numri i teritorit 84285210		33 Kodet origjinit 34 Peshë bruto (kg) 35 Preferenca	
36 Procedura 4000 000		37 Peshë neto (kg) 4,945.00	
38 Peshë neto (kg) 4,945.00		39 Kosto 1	
40 Dokumenti parapërdorur, përmbledhës S1		41 Hapësira plotësuese PCE 1.00	
42 Çmimi për njësi 11,000.00		43 M.V. 6 kusht	
44 Kodi LSI 1.050		45 Regjistrimi 1.050	
46 Vlera statistikare 21,102.60		47 Vlera statistikare 21,102.60	
48 Vlera statistikare 21,102.60		49 Identifikimi i dapos	
49 Identifikimi i dapos 21,102.60		50 Principali Nr	
50 Principali Nr		51 Identifikimi C ZYRA E NJES	
51 Identifikimi C ZYRA E NJES		52 Zyra e destinacionit dhe vendi	
52 Zyra e destinacionit dhe vendi		53 Zyra e destinacionit dhe vendi	

Meqenëse ekspertja shqyrtuese nuk është eksperte teknike me njohuri specifike në fushën e ndërtimit, sqarojmë se kemi hulumtuar në internet sipas termit ngarkues dhe në bazë të hulumtimit në internet ekskavatori nuk hyn në kategorinë e “ngarkuesit”. Sipas hulumtimit në internet rezulton që një ekskavator është projektuar për të gërmuar papastërtitë ndërsa një “ngarkues” me rrota lëviz lehtësisht materialet në vend. Dallimi kryesor midis këtyre dy makinave qëndron në qëllimin e tyre kryesor. Së pari, është kapaciteti i kovës. Ngarkuesit me rrota janë shumë më efikas në lëvizjen e materialeve sesa ekskavatorët. Më poshtë është shkëputur rezultati i kërkimit në internet:

About 16,300,000 results (0.46 seconds)

An excavator is designed to dig up dirt while a wheel loader moves materials around easily onsite. The key difference between these two machines lies in their primary purpose. Firstly, there's the bucket capacity. Wheel Loaders are much more efficient at moving materials than excavators. May 6, 2022

Andaj, ekspertja shqyrtuese në bazë të hulumtimit në internet, konsideron se nuk qëndron pretendimit i OE ankues.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se AK e ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE i cili ka tejkeluar vlerën e parashikuar të kontratës, nga vlera 35,705.98 euro, ka rekomanduar për kontratë ofertën me çmim 42,339.11 euro, që i bie 6,633.13 euro më shumë se vlera e parashikuar e kontratës dhe në dallim nga oferta e OE ankues në shumë prej 12,701.37 euro.

Ekspertja shqyrtuese ka kërkuar nga zyra e prokurimit nëse posedojnë deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve në vlerë 42,339.11 euro, si dhe të na dërgohet kjo deklaratë. Lidhur me këtë kërkesë drejtuar AK-së, me datë 28.12.2022 AK përmes e-mailit zyrtar na ka bashkangjitur shkresat, kërkesën drejtuar njësisë kërkesë për pjesën shtesë të fondeve, si dhe Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve me mjete shtesë në vlerë 6.632.13 euro.

Provë:


1. Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve 27.10.2022

Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në shkresat e lëndës, grupi i OE ankues “Erpower” sh.p.k.& “Voltechz” sh.p.k. – Viti, me datë 07.12.22 ka bërë kërkesë për qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë. OE i rekomanduar për kontratë në bazë të Aneksit 3 Kërkesa për sekrete afariste ka kërkuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit që Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të klasifikohen si sekrete afariste.

AK-Komuna e Gjilanit ju ka drejtuar OE të rekomanduar për kontratë që ti lejohet qasja në dokumente operatorëve ekonomik të interesuar për këtë aktivitet. Përgjigjja e OE të rekomanduar për kontratë ka qenë se operatori ekonomik mund të ketë qasje virtuale (të shikoj) në dokumente por nuk lejohet ti marr kopje në formën fizike apo elektronike. Bazuar në shkresat e lëndës gjendet procesverbali i datës 07.12.2022, ku përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues “ERPOWER” SHPK ka pas qasje virtuale në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E GJILANIT
 OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
 BELEDIYESI



Zyra e Prokurimit – Procesverbal

DATE/A:	07.12.2022
Filloi :	13:50
AK – Autoriteti Kontraktues	Znj. Rrezelina Uka
OE - Operatori Ekonomik	Z. Erblin Zejnullahu Përfaqësues i "Erpower" sh.p.k.
Aktiviteti i Prokurimit :	Rregullimi i bazamentit për vendosjen e trafos
Numëri i Prokurimit :	651-22-12818-5-2-1
Numëri i Brendshëm :	GL. 651 022.111 521
Mbaroi :	14:00

Pretendimi tjetër i OE ankues të cilin e ka cekur në ankesë që ka të bëjë me tenderët jo normalisht të ulët, ku pretendon se nëse janë dy ofertues atëherë nuk vlejné rregullat për tender jo normalisht të ulët.

Ekspertja shqyrtues sqaron se OE ankues nuk është eliminuar për shkak të çmimit jo-normalisht të ulët por në mungesë të pajisjes tek pika 5 Ngarkues të Aneksit 7 të specifikacioneve teknike të detyrueshme. Për më tepër, ekspertja shqyrtuese gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës për këtë procedurë sqaron se nuk ka hasur në ndonjë shkresë në të cilën është trajtuar tenderi i OE ankues apo OE të rekomanduar për kontratë si tender jo normalisht i ulët. Pra çështja e “tenderit jo

normalisht të ulët” ceket vetëm në pikën ankimore të OE ankues dhe jo në ndonjë shkresë të AK-së. Andaj, pretendimi është i paqëndrueshëm.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 25.01.2023 me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në këtë rast për nevojat e këtij vendimi konstatohet (shkurtimisht) se, të dyja palët kanë qëndruar prapa pretendimeve të tyre.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron, se:

Paneli shqyrtues e klasifikon të pabazuar pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues se tek Aneksi 7, pika 5 Ngarkues nuk figuron kjo pajisje ashtu siç është kërkuar nga AK në dosjen e tenderit, si dhe në njoftimin për kontratë. Sa i përket mungesës së kësaj pajisje, në seancën dëgjimore deklarohet edhe vet përfaqësuesi i OE ankues, nuk e ka ofruar sipas Dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt nenit 41 (Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës) të LPP, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka dhënë përfundimisht një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura dhe duke i ndërmarrë një serë veprimesh të cilat parashihen shprehimisht me LPP, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen në këtë rast.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që

aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi Komunal Gjilan

1x1 OE, "Erpower" sh.p.k. & "Voltechz" sh.p.k me seli Viti

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.